

Dr. sc. Marica Čunčić

SHËRIMI ME ANË TË FESË

Prishtinë, 2004.

Biblioteka: “BURIMI I JETËS” – Vëllimi 2.

Titulli i origjinalit:

Dr. sc. Marica Čunčić:

VJEROM DO ZDRAVLJA

Đakovo, 2001.

Redaktori: Don Nosh Gjolaj, SDB.

Përkthyen: M. Svyetlana Rezo,
m. Lujza Stošić,
Gjon Kelmendi

Lektura: Fra Lovro Gavran, OFM

Boton: “Shpresa” – Prishtinë

Parathënie

Lexues i dashur!

Ja edhe një libër në vargun e Bibliotekës së Provanisë së Zotit: “Burimi i jetës”

Maricën, autoren e këtij libri e njoh mirë. Bashkëpunojmë me vite. Vetë jam dëshmitare e shumë hireve të Zotit nëpërmjet saj. Përkundër të gjithë titujve që i ka, ajo është aq e thjeshtë, që të gjithë e quajmë vetëm Marica.

Ishte shumë e lumtur kur mori vesh se e përktheva këtë libër dhe nëpërmjet saj Zoti na e dhuroi edhe sponzorin.

Mjerisht, njeriu i sotëm, i shkëputur nga rrënjët e vet, nga Zoti, Burimi i jetës, bie viktimë e sëmundjeve të ndryshme dhe, duke e kërkuar shërimin, shpeshherë e kërkon në rrugë të gabueshme (te falltorët, magjistarët, “dijetarët” e rrejshëm etj.), të cilët gjendjen e tyre edhe e keqësojnë dhe e bien në gjendje pa rrugëdalje.

Ne në fenë tonë katolike kemi dhuratën e Zotit që të mund ta ruajmë shenëdetin, duke jetuar në harmoni Zotin, me njëri-tjetrin dhe me natyrën – si edhe që me anë të hirit të Zotit ta fitojmë shërimin si në pikëpamje shpirtërore dhe psikike, po ashtu edhe në pikëpamje fizike.

Jezusi thotë: “Mjeku nuk u duhet të shëndoshëve por për të sëmurëve” (Mt 9, 12); “unë erdha që ... ta kenë jetën, e ta kenë me plotësi” (Gjn 10, 10); “që gëzimi juaj të jetë i plotë” (Gjn 16, 24).

Pra, të kthehemi rrënjave tona të krishtera dhe Jezu Krishtit, të vetmit Shëlbues, të vetmit ndërmjetës ndërmjet Zotit e njerëzve. Vetëm ai është paqja jonë.

Kjo librezë nuk do të shitet, por do të shpërndahet falas bibliotekave të qendrave shpirtërore. Rekomandojmë që lexuesit t'ua japin dhe t'ua rekomandojnë shokëve dhe shoqeve të veta – ose t'a kthejnë qendres ku e kanë marrë, për ta lënë në disponim lexuesve tjerë.

Biblioteka «Burimi i jetës» dëshiron t'ua ofrojë rastin edhe atyre personave që kanë mundësi të bëjnë diçka të mirë në pikëpamje shpirtërore për popullin tonë shqiptar, sepse «njeriu nuk jeton vetëm prej buke, por prej çdo fjale që del nga goja e Hyjit» (Mt 4, 4). Edhe disa libra tjerë janë përkthyer dhe, për t'u botuar, presin vetëm donatorin. Informatat mund të merrni në telefon nr. 00377/44/119-701.

Po i falënderoj Zotit dhe të gjithë bashkëpunëtorëve dhe mirëbërësve që kanë dhënë kontributin e vet për botimin e kësaj vepre. Zoti i bekoftë dhe i shpërbleftë të gjithë!

M. Svjetlana Rezo, FDC

H y r j e

Feja ndikon në qëndrimin e njeriut, madje edhe në shëndet, i cili është shpesh pasojë e qëndrimit tonë ndaj ngjarjeve në ne dhe rreth nesh. Ai që beson, ka një qëndrim të caktuar ndaj vetvetes dhe ndaj botës. Në kohëra të caktuara të krishterët kanë reaguar në mënyra të ndryshme dhe kanë theksuar ato aspekte të fesë së vet, të cilat në momentin e caktuar u nevojiteshin më së shumti ose ua kanë dhënë kuptim jetës. Kështu në shoqërinë skllavopronare është theksuar shpërblimi i Krishtit, në feudalizëm dëmshpërblimi për mëkate, në kapitalizëm meritat e Krishtit,¹ në komunizëm lirimi, e sot, sipas gjasave, për shkak të katastrofës së mundshme ekologjike dhe morale, rritet vetëdija mbi ndikimin terapeutik të fesë dhe se Krishti shpëton nga mëkati dhe nga pasojat e tija. I Krishteri bashkëkohor përherë e më tepër bëhet i vetëdijshëm që së bashku me akumulimin e trashëgimeve të qytetërimit dhe të kulturës, ka ndodhur edhe akumulimi i mëkateve të të parëve dhe i pasojave të tyre, dhe se të gjitha këto gjëra negative vijnë në shprehje në të tashmen, prandaj në fe gjen strehimin nga devijimet njerëzore, të cilat kërcnohen me zhdukjen e shëndetit dhe të ekzistencës. Në Kroaci numri i katolikëve është i madh (76,6 %)² dhe ata çdo herë e më tepër marrin pjesë në

¹ Krh. Stjepan Kushar, "Ponuda bez potražnje", Kana, Revistë familjare e krishterë, 2/342, viti XXXII, shkurt 2001, fq. 15.

² Sipas statistikës së bërë nga Vatikani në vitin 1991, e botuar 31. 12. 1997, në botë ka një miliard dhe pesë milionë katolikë (17,3 % e popullatës). Së bashku me të krishterët e tjerë bëjnë 33,4 % njerëz në tokë.

trendet botërore, të cilat do të mund të quheshin: shërimi me anë të fesë, duke vizituar shenjtëroret e ndryshme ose seminarët në stadione, ku lutet për shërimin e brendëshëm ose shpirtëror e psikik, si edhe për shëndetin fizik.

Prej nga sëmundjet e shumta?

Dielli është burimi i ngrohtësisë dhe i dritës për mbarë jetën fizike në tokë. Prej kohës kur e kemi dëmtuar mbështjellësin e ozonit rreth Tokës me provat bërthamore, për shkak të emitimit të avujve helmues dhe të tymit, jemi të ekspozuar rrezatimit të rrezikshëm të rrezeve të diellit, ndryshimit të temperaturës dhe të klimës. Paraardhësja e katastrofës ekologjike, që njerëzimit i qëndron mbi kokë, për shkak të vrimës së ozonit, gjithsesi janë sëmundjet e ndryshme. Duke shkuar në qytete për shkak të punës, njeriu e braktis natyrën, kontaktin me tokën, bimët, lulet. Duke mësuar prej makinave dhe kompjutorëve, të tjerët i trajton me ftohtësi, nuk ka shok të cilit do të mund t'ia thoshte të gjitha, dhe nuk ka kohë që ta dëgjojë dikend. I vetmuar në rrëmujën e qytetit, njeriu bie në depresion. Në vrapim pas pasurisë, i dëshiron të gjitha menjëherë, shpesh merret me gjërat më tepër sesa me njerëzit, fitimi është më i rëndësishëm për të se ndonjë e mirë, madje edhe se vetë njeriu. Më shumë dëshiron që të ketë sesa që të jetë, andaj kërkon ata që kanë, duke urryer ata që “vetëm” janë. Kështu tjetërsohet. Barra e jetës jonatyrore dhe jonjerëzore bëhet shumë e rëndë dhe është vetëm pyetje e kohës kur do të bjerë entuziazmi.

Njeriu, shpesh herë, e trajton trupin e vet si makinë, në të cilën e fut ushqimin duke e përpirë pa e përtypur, sepse ngutet. Cilësinë e ushqimit të shumëllojshëm e zëvendëson ushqimi i njëllotë. Shpesh herë shpenzon sasi të mëdha të hollash për gosti me ushqim kryesisht jo të shëndoshë. Derisa në njërin anë propagohen dhe masovikisht

prodhohen e shiten ushqime dhe pije jo të shëndosha, por tërheqëse, në anën tjetër kërkohet që njeriu, e sidomos gruaja, të jetë thatanike. Këtu buron anoreksija pastaj edhe bulimia, epidemi e madhe në botën femërore të Perëndimit, ku çdo e pesta ose e katërta femër është e përfshirë nga këto çrregullime, të cilat vënë në pyetje aftësinë e saj si grua dhe nënë për shkak të jostabilitetit emocional.

Jostabiliteti emocional është i dukshëm edhe për shkak të frikës nga obligimi për tërë jetën, sikurse që janë kurora e martesës ose celibati. Në rini, para martesës, njeriu shkon deri tek kufijt e skajshëm të shpirtit dhe trupit të vet, duke mos rrespektuar ligjin themelor të psikologjisë të pezullimit (shtyrjes për më vonë) të knaqësisë. Mirëpo, në martesë çdo gjë ndërrohet dhe partnerët nuk kuptohen. Është një mosdije e madhe në fushën e komunikimit në mes të partnerëve. Një përqindje e madhe e burrave jepet pas alkoholit, sepse bashkëshortet e tyre ua mungojnë dhurimin martesor, që më vonë duket e kundërta, se gruaja është viktimë e burrit të sajë alkoholist. Shpesh idila martesore përfundon te avokati, i cili vendos se kujt do t'i takojë fëmija. Përqindja frikësuese e shkurorëzimeve dekurajon të rinjtë që të martohen. E të mos flasim për plagët shpirtërore të fëmijës së prindërve të ndarë.

Gratë janë të ndera (të tensionuara), sepse u duhet të punojnë që familja të mbijetojë, dhe nuk mund t'i kushtohen edukimit të fëmijëve të vet, gjë që nuk paguhet në afat të gjatë, sepse më vonë vijnë problemet me fëmijët, të cilët e trondisin mbarë familjen. Pasiguria në punë, tronditjet në themelet e organizatave në të cilat punojnë, shpërnguljet e domosdoshme për shkak të punës, pasiguria

se a do të paguhen të arrdhurat personale, a do të marrë ndonjë gjë për punën jasht orarit ose për punën e natës, a do t'i japë pronari rrobat mbrojtëse ose helmetën, para se t'i ndodhë ndonjë lëndim serioz, a do ta marrë gjumi në punë gjatë natës, a do të mund të ushqejë familjen e vet dhe të blejë çdo gjë që fëmijët kanë nevojë, të gjitha këto njeriun e trondisin dhe shokojnë.

Në Perëndim sindikatat tanimë punojnë mirë dhe raportet në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve, mund të rregullohen nëse nuk janë të mira. Në demokracitë e reja ka shumë pak sindikata që të drejtat e të gjithë punëtorëve të jenë të mbrojtura. Qytetarët kanë përjetuar strese dhe frustrime gjatë kalimit prej shoqërisë socialiste në ate kapitaliste dhe në ekonominë e tregut. Ka shumë ndërmarrës, të cilët punëtorëve të vet nuk u ofrojnë të drejtat themelore. Në disa vende gjendja është shumë më e ndërlikuar, sepse ka shumë të sëmurë psikikë dhe invalidë në shpirt dhe në trup, të cilët marrin doza të mëdha sedativash në shtëpi ose në institucionet për të sëmurët mentalë, e në mesin e tyre përqindja e vetëvrasjeve është alarmante, për shkak të dëshpërimit.

Gjendjet traumatike në shoqërinë krijohen për shkak të papunësisë së madhe dhe jolikuiditetit. Kjo është njëri prej shkaqeve të frikës nga martesat. Shumë vende, në Kroaci për shembull, kanë me dhjetëra e qindra persona të pamartuar në të tridhjetat. Kështu zvogëlohet nataliteti, rritet vetmia dhe pakënaqësia.

Për këkë shkak njerëzit ju qasen zgjedhjeve të shpejta të praktikave okulte, të cilat janë shumë prejse është në fuqi liria e fjalës. Premtojnë nirvanën, kontrollën e plotë, ekspansionin e trurit, qeverisjen e përsosur me vetëveten

dhe të tjerët, profetizojnë jetën e ardhshme dhe fusin në botën ezoterike gjëra prej të cilave vështirë dilet. Shumica ikin nga vetvetja në drogë ose alkohol.

Përveç këtyre shkaqeve të sëmundjeve të cilat janë në planin ekologjik, ekonomik, shoqëror, familjar dhe politik, e të cilat kërkojnë nga ne vëmendje të plotë për menjanimin e tyre, shkakun më të thellë të sëmundjeve e gjen teologjia. Sëmundja është pasojë e mëkatit, thotë mësuesi i madh i Kishës katolike, shën Tomë Akuini. Nëse është me rëndësi që të gjendet shkak i drejtpërdrejtë i sëmundjes, për shkak të gjetjes së ilaçit, atëherë ka vlerë të paçmueshme edhe fakti se sëmundja është pasojë e mëkatit të parë dhe mëkatit të njerëzimit deri tek mëkatet tona bashkëkohore, kolektive, strukturore dhe personale, që i kemi bërë me mendime, fjalë, vepra dhe lëshime. Kështu sëmundja merr një dimension të ri shpirtëror, që hap mundësitë e trajtimit dhe shërimit adekuat. Nëse sëmundja është pasojë e mëkatit, atëherë Jezu Krishti është ilaçi, sepse Ai ka vdekur për mëkatet tona, që të na shpëtojë. Të Premten e madhe lusim që bari të na vijë nga druri i kryqit të Krishtit, sepse edhe armiku-djalli, na ka lënduar nga druri në parajsën e tokës, kur të parët tanë i ka mashtruar,³ që të bëjnë mëkatin e parë: “Dhe prej atje le të na vijë ilaçi (prej druri), prej ku armiku na ka plagosur.”⁴

³ Zan 3, 1-24. [Bibla, Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, DRITA, Ferizaj 1991. Të gjitha citatet me shkurtime në këtë librezë i kam marrë nga Bibla, botuar nga DRITA, Ferizaj 1994, fq. 1804.]

⁴ *Meshari Romak*, DRITA, ORDINARIATI I PESHKVISË SHKUP-PRIZREN, Nr. P-400, Nga liturgjia e së Premtes së madhe, Himni Kryqit të shenjtë, strofa e dytë, fq. 198.

Legjitimiteti i shpresës në shërim me anë të lutjes

Nuk sëmuren të gjithë njerëzit njësoj dhe nuk i bartin dhembjet me duresë të njëjtë. Ekziston dallim i dukshëm në mes të besimtarëve dhe të patënzonëve. Feja zgjon shpresën, i jep kuptim dhe forcë të nevojshme jetës. Në numrin tematik të javores kanadeze *Macleans*, të kushtuar religjiozitetit të Kanadezëve, sillen shqyrtimet që tregojnë se ata të cilët shkojnë në kishë janë më të lumtur dhe më të kënaqur në jetë sesa të tjerët. E të jesh i kënaqur, është gjithsesi predispozitë e mirë për shëndet. Kjo shihet në studimin e sociologut nga Purdue University, Indiana, ShBA, i cili konstaton se të krishterët praktikë janë më të shëndoshë se të tjerët.⁵ Është gjë e njohur se në kontinentin e Amerikës Veriore besimtarët sëmuren më rrallë, e të sëmuret besimtarë shërohen më parë dhe largohen më shpejt nga spitali se sa të tjerët në kushte të njëjta. Kjo statistikë nuk ka qenë e vështirë të bëhet, sepse me rastin e shkuarjes në spital pacientët rregullisht plotësojnë pyetësin në të cilin së bashku me historinë e sëmundjes, shkruajnë edhe përkatësinë e tyre fetare, kështu që mund t'u mundësohet edhe "kujdesi shpirtëror" nëpërmes të bisedave dhe pranimit të sakramenteve të shenjta të rrëfimit, kungimit dhe vajimit.⁶

⁵ "God is Alive, Special Report: the religion Poll", *Macleans's*, Canada's Weekly Newsamagazin, April 1993, 33.

⁶ Për shembull, derisa kam marrë kemoterapinë në Brampton, Ontario, Kanada, 1993/4. me mua kanë biseduar shpirtërori i atij spitali. Biseda ka kaluar në atmosferë shumë të ngrohtë, në lutjen e

Mund të shihet dallimi në mes të atyre që nuk lutën dhe atyre që jetojnë me Zotin në lutje. Jeta e rregullt, ushqimi i shëndoshë dhe modest, takimi me Zotin në lutje, të gjitha këto i bëjnë të shëndoshë dhe të lumtur. Agjërimi ndikon mirë, sikurse që lutet në meshën e shenjtët: “agjërimet tona të jenë ty të dashura dhe neve shëruese”.⁷ Nëse vjen sëmundja fizike, shpirti dhe psiha janë të fortë në Zotin dhe shërohen shpejt⁸ ose në qetësi durojnë vuajtjen dhe e shndërrojnë në vuajtje shpërblyese. Lutja ndikon mirë, madje edhe në shëndetin mental. Në Amerikë, p. sh. është dokumentuar se besimtarët të cilët lusin në gjuhë të ndryshme⁹ kanë shëndet mental pak më të mirë sesa grupet kontrolluese, me të cilat janë krahasuar, si edhe se norma e përgjithshme shoqërore.¹⁰

përbashkët dhe në lavdërimet e Zotit në kapelën e spitalit. E ka parë se unë qëndroj mirë në këtë situatë dhe më nxiti që kështu edhe të vazhdoj, sepse nuk kam qenë në pushim mjeksor dhe kam vazhduar punën.

⁷ Meshari Romak, E Mërkura e Përhime, lutja pas kungimit, fq. 122.

⁸ Kur kam pasë 19 vjet, kam pasë tuberkulozin. Në spital jam lutur shumë dhe kam qenë e lumtur sepse kam pasur “ndihmën shpirtërore” nga ana e Kishës (më ka vizituar bashkësia katekistike e rinisë, dhe kam pasur rregullisht rrëfimin dhe kungimin). Jam shëruar për 4 muaj (prej 7-11 1970), çka është konsideruar si shërim shumë i shpejtë. Mjeku më ka thënë se jam shëruar aq shpejt, sepse kam qenë e gëzueshme.

⁹ Dhurata e gjuhëve të huaja është dhuratë e Shpirtit Shenjt, krh. 1 Kor 12, 10; Vap 2, 4-11; 10, 46.

¹⁰ Edward O'Connor, C.S.C. *The pentecostal Movement in the Cathollik Church*, Ave Maria Press, Notre Dame, Indiana 46 556, 1973, 124. Përvoja ime e vërteton këtë fakt, sepse prej kur kam filluar për të lutur në gjuhët e huaja, kam gëzim më të madh në jetën time.

Krishti e ka mundur vdekjen dhe sëmundjet e shpirtit dhe të trupit me vdekjen dhe ngjalljen e tij. Duke patur parasysh Krishtin e ngjallur, të krishterët besojnë në ringjalljen e trupit dhe në jetën e pasosur. I krishteri nuk i ka frikë vdekjes, sikurse tregojnë martirët e shumtë, të cilët e kanë dhënë jetën për Krishtin. Ai i cili ka shëruar gjatë jetës së vet, ka premtuar pavdeksinë e shpirtit dhe të trupit, ashtu sikurse meshtari lutet në meshë: “të bëhemi pjestarë në pavdeksinë së Jezu Krishtit, i cili me vdekjen e vet e mundi vdekjen tonë.”¹¹ Më në fund shëndeti fizik është pashkatrueshmëria e trupit, i cili do të ringjallet: “Shikoje, o Zot, popullin tënd. Ti e ke përtrirë me misterin e jetës së pasosur: bëj që të arrijë lavdinë e pashkatërrueshmërisë me ngjalljen e trupit.”¹² Ashtu sikurse që me mëshirë mund të fitohet falja e mëkateve dhe i krishteri mund të ketë jetën e pasosur, e kjo do të thotë shëndetin e amshuar, ashtu mund që me mëshirë të fitohet edhe shëndeti kohor. Shpresën në shërim nuk mund ta asgjësojmë, e që me atë rast të mos e shtrembërojmë Shkrimin shenjt, sakramentin e vajimit dhe lutjet liturgjike të Kishës.

Shërimet janë njëra prej temave të Shkrimit shenjt, sidomos në Besëlidhjen e Re.¹³ Zoti thotë vetë: “Unë jam Zoti që të shëron.”¹⁴ Mirjam është shëruar nga gërbula kur

¹¹Meshari Romak, 18. Dhjetor, fq. 94 Lutja mbi dhuratat.

¹²Lutja pas kungimit e së dielës, java II. pas Pashkëve, fq. 137; ose Java III. e Pashkëve, fq. 244; dhe të martën, java III. e Pashkëve, fq. 246.

¹³Per shembull: Mt 8, 16; Mt 12, 15; Lk 4, 40; Lk 6, 19.

¹⁴Dal 15, 26.

është lutur Mojsiu: “O Zot, të lutem, shëroje!”¹⁵ Të paktën në njëzet vende në Bibël lexojmë për shërimet. Profeti Isaia thotë: “Me plagët e tija u shëruam” – duke menduar në Shpëtimtarin e premtuar qindra vjet para ardhjes së tij në botë.¹⁶ Në Besëlidhjen e Re lexojmë sesi është realizuar kjo me ardhjen e Krishtit: “Kur u bë natë i sollën shumë të djallosur. Jezusi me fuqinë e fjalës i dëboi shpirtrat dhe i shëroi të gjithë të sëmurët, që kështu të plotësohej fjala e Isaisë profet që thotë: “Ai i mori lëngatat tona e i mbarti sëmundjet tona.”¹⁷ Kush ka arrdhur te Krishti dhe është lutur, lutja e tij është plotësuar: “E u hap zëri për të anembanë Sirisë: i sillnin tek ai të gjithë ata që i mundonte ndonjë e keqe prej sëmundjesh e ndeshtrashash të larmishme – të djallosur, epileptikë, të shituar; dhe i shëronte.”¹⁸ Tri të katërtat e ungjillit të Markut janë të kushtuara mrekullive të Jezusit. Përse atëherë ka aq shumë të sëmurë? Ati DeGrandis, meshtar katolik, i njohur për dhuratat e predikimit dhe të shërimit, sheh shërime të panumërta kur lutet për njerëzit. Në njërin prej librave të tij të shumtë, ai thotë: “Në Besëlidhjen e Re është krejtësisht e qartë se Jezusi dëshiron që të gjithë njerëzit të shërohen, por nuk kanë arrdhur të gjithë, dhe nuk vijnë sot të gjithë që të luten për shërim. Secili duhet që në fe ta prekë Jezusin. Askënd nuk mund ta detyroni që të shërohet.”¹⁹ Prandaj Jezusi thotë: “Lypni, e do t’ju jepet!

¹⁵ Nm 12, 13.

¹⁶ Is 53, 5.

¹⁷ Mt 8, 16-17.

¹⁸ Mt 4, 24.

¹⁹ Robert DeGrandis, S.S.J. *Lay Person's Manual for the Healing Ministry*, printed in USA, 1985, 2. Përktheu M. Ç.

Kërkoni dhe do të gjeni, trokitni e do t'ju çelet! Sepse kush lyp, i jepet, kush kërkon gjen, e kush trokëllit, i çelet.”²⁰ Sipas Tomë Akunit, sëmundja, si pasojë e mëkatit, mund ta keqësojë dobësinë shpirtërore të të sëmurit.²¹ Me sakramentin e vajimit këthehet forca shpirtërore dhe shpresa në shërim. Rrënja ose fillimi i këtij sakramenti është në Letrën e Jakobit: “Është ndokush ndër ju i sëmurë? Le t’i thërrasë udhëheqësit e Kishës. Ata le të lutën mbi te duke e lyer me vaj në emër të Zotit dhe urata e fesë do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta ripërtëritë, e në qoftë se ka bërë mëkate, do t’i falen.”²² Prandaj në këtë sakrament meshtari lutet: “Shëroji, të lutemi Shelbuesi ynë, me hirin e Shpirtin Shenjt, dobësitë e këtij shërbëtori tënd. Shëroji plagët e tyre, falja mëkatet dhe largoja çdo sëmundje të shpirtit dhe trupit dhe me mëshirën tënde ktheja shëndetin, le të rikthehet në detyret e veta të mëparshme.”²³

Edhe pse sakramenti i vajimit më herët është quajtur sakrament i të vdekurve dhe është dhënë vetëm pak kohë para vdekjes, sot dihet qartë se ai është sakrament i shpresës në shërim. “Që nga lufta e dytë botërore e këtej, jemi dëshmitarë të përtëritjes më të thellë të teologjisë së

²⁰ Mt 7, 7.

²¹ *Contra Gentiles*, IV, 73. Citatet sipas Dr. Marin Srakić, “*Sakramenti i Vajimit, sakramenti i shpresës dhe forcimit në sëmundje*”. Bogoslovna smotra, Viti XLVIII, Zagreb, 1978, nr. 3-4, 266.

²² Jak 5, 14-15.

²³ Slavimo Boga, *Hrvatski katolički molitvenik i pjesmarica*, Hrvatski naddušobriznički ured u Njemačkoj, Frankfurt am Main, Knecht 1982, 46.

vajimit, që revalorizon efektin trupor dhe tenton që të jepet edhe jashtë rrezikut të vdekjes.”²⁴ Në mënyrë të veçantë theksohet efekti i tij shërues në trup: “Vajimi i shenjtë është sakrament i të sëmurëve, e jo i atyre në prag të vdekjes. Ky vaj me veprimin e tij, vërtet, i ndihmon besimtarit të sëmurë rëndë, e jo vetëm shpirtit të tij, por edhe trupit, nëse kjo është e dobishme për shpirtin. Ai, pra, është sakrament i shpresës, shpirtërore dhe trupore, e jo sakrament i atyre që janë para vdekjes.”²⁵ Ka tendenca që shërimi të shikohet si metaforik, e jo si i vërtetë: “Por kemi dëshmi të qarta se vajimi është sakrament i ligjit të ri, që ka për qëllim faljen e mëkateve dhe shërimin trupor.”²⁶ Madje mund të thuhet se nuk është primare falja e mëkateve, por pikërisht shërimi. “Nëse falja e mëkateve është njëri nga efektet e vajimit, ai gjithsesi është eventul dhe ndodh rastësisht.”²⁷ Shprehimisht theksohet: “Çdo përshpirtëri që do të heshtonte ose harronte efektin trupor, nuk do të ishte në rregull.”²⁸

Sakramenti i vajimit në Kishë po bëhet përherë e më i dashur dhe më i popullarizuar. Përveç mënyrës individuale të dhënies, jepet edhe të gjithë të sëmurëve të pranishëm në Kishë që dëshirojnë dhe ndodhin shërimet. Kisha ka shpjeguar me sukses qëllimin e sakramentit të vajimit duke u kthyer në praktikën e të krishterëve të parë, kur të parët e Kishës i kanë lyer me vaj të sëmurët dhe ata

²⁴ Dr. Mari. Srakiq, vep. cit., 262.

²⁵ Po aty, 255.

²⁶ Po aty, 261.

²⁷ Po aty, 265.

²⁸ Po aty, 263.

janë shëruar. Kështu është forcuar besimi se Krishti e ka mundur jo vetëm vdekjen, por edhe sëmundjen dhe se lutja për shëndet është legjitime njësoj sikurse edhe lutja për jetën e pasosur. Fitorja e Krishtit është edhe fitorja e Kishës. “Vajimi i shenjtë është akt i Kishës, e cila e ka mundur mëkatin, sëmundjen, vdekjen, e që jepet për të freskuar të krishterin e sëmurë. Dmth., efekti eklezial i këtij sakramenti është vaksinim specifik në Kishë, të shikuar si bashkësi fitimtare, e cila fëmijëve të vet ua jep atë fitore.”²⁹ Kisha e përcjell këtë fitore. E përcjell nëpër lutjet dhe sakramentet e veta, me besim që Jezusi edhe sot dëshiron që t’i shpëtojë të gjithë. Shërimi përfshihet në shpëtimin e tërësishëm të njeriut, trupit të tij, psihës dhe shpirtit.

Në kishë gjithmonë është lutur për shëndet, sepse Jezu Krishti nëpërmes të mundimit dhe ngjalljes së vet ua ka kthyer njerëzve shëndetin e humbur në parajsën e tokës me rënien e njeriut të parë. Kisha na tregon se edhe me lutjet e saja liturgjike është e mundur që të fitohet shëndeti, sikurse edhe falja e mëkateve dhe jeta e pasosur, sepse Shpëtimtari i gjinisë njerëzore e ka siguruar edhe shëndetin me vdekjen dhe ngjalljen e vet, sidomos me vuajtjen e vet, sepse “me plagët e tija, ne u shëruam”.³⁰

Këte e vërtetojnë edhe shumë lutje liturgjike, duke filluar nga ato në të cilat lutemi në mënyrë të përgjithshme: “Na i fal mëkatet dhe na ndihmo në nevojat e jetës,”³¹ nëpër ato në të cilat kërkohet ndihma për

²⁹ Po aty, 267.

³⁰ 1 Pjt 2, 24.

³¹ *Meshari Romak*, lutja e javës së I. të Arrdhjes, e martë, fq. 74.

përballimin e vuajtjeve dhe kthimin e shëndetit: “Mos lejo që të dëshpërohemi nga lodhja dhe sëmundja, derisa presim ardhjen e Birit tënd i cili na jep forcën dhe shëndetin”³² – e deri te ato që kërkojnë që sëmundja të largohet: “Lusim Zotin Atë të gjithpushtetshëm që të largojë sëmundjet, dhe të japë të sëmurëve shëndet”³³ Lutemi para Pashkëve që “të shëndoshë të arrijmë të kremten e Pashkëve”,³⁴ E të Hënen e madhe lutemi për Papën: “le ta ruajë Zoti shëndosh e mirë për Kishën e vet”.³⁵ Në meshën për të sëmurë lutemi: “Për këta të sëmurë: që me bekim shpirtëror t’i shpërblesh dhembjet e tyre, t’i zbutësh vuajtjet dhe sipas vullnetit tënd t’ia kthesh Kishës sate të shëndoshë”³⁶ dhe: “O Zot Jezu Krisht, ti që gjatë jetës sate tokësore ke shëruar sa të sëmurë, dëgjoji lutjet tona dhe me mëshirë shikoji këta të sëmurë, zbutjau dhembjet, jepja sëmundjes së tyre frytetet e hirit dhe shërimin”.³⁷

Kungimi i shenjtë është burim i forcës për betejat e jetës dhe burim shëndeti. Ndikon shumë shërueshëm. Meshtari para çdo kungimi të shenjtë lutet që marrja e Korpit dhe e Gjakut të Krishtit, sipas mirësisë së Zotit, “të jetë për shpirtin dhe trupin mbrojtje dhe bar.”³⁸ Zoti e

³² Java e II. e Arrdhjes e merkurë, fq. 82.

³³ Lutja e gjithmbarshme e Të Premtes së madhe, fq. 190.

³⁴ Lutja e Të enjëtes së javës së IV të Kreshmëve, fq. 155.

³⁵ Lutja e gjithmbarshme, fq.190, në Të Premten e madhe.

³⁶ Lutja e besimtarëve, Kršćanska sadašnjost, Zagreb, 1981, 179.

³⁷ Po aty.

³⁸ Lutja përpara kungimit, fq. 418.

forcon jetën tonë “me forcën e mistereve të shenjta.”³⁹ Bashkimi i natyrës sonë njerëzore me Hyjninë e Jezu Krishtit në Kungimin e shenjtë është burim i përtëritjes së vazhdueshme: “Na përtërij në përgjasimin e Jezu Krishtit, në të cilin është bashkuar natyra jonë njerëzore me Hyjninë tënde”.⁴⁰ I krishteri e pranon se është i dobët, i lënduar, prandaj meshtari lutet që marrja e Kungimit të shenjtë “të na përtërijë jetën, t’i shërojë plagët e mëkatit dhe të na mbrojë për arrdhmëri”.⁴¹ Jezusi në Kungimin e shenjtë është bar i vërtetë: “Letë na përshkojë forca e Krishtit, i cili është bar për dobësinë tonë”.⁴²

Lutja e centurionit u dëgjua: “O Zot, unë nuk jam i denjë që të hysh nën pullazin tim, por vetëm jep urdhër e do të shërohet shërbëtori im.”⁴³ Krishti e shëroi shërbëtorin e sëmurë, pa shkuar fare në shtëpinë e tij. Kjo lutje ka hyrë në liturgji dhe besimtarët e lusin para Kungimit të shenjtë. Shqip thuhet: “O Zot, unë nuk jam i denjë që të hysh nën pullazin tim, por thuaje vetëm një fjalë, e shpirti im do të shërohet”.⁴⁴

Përkthimi anglez është më besnik kuptimit biblik dhe nënkupton shërimin e gjithmbarshëm: “Lord, I am not worthy to receive you, but only say the word and *I shall be*

³⁹ *Meshari Romak*. Lutja pas kungimit, më 29 Dhjetor, Dita e pestë e të tetëshes së Krishtlindjes, fq. 106. dhe të hënën pas 2 janarit fq. 114.

⁴⁰ Lutja mbi dhuratat e meshës se mesnatës në Krishtlindje, fq. 102, dhe lutja e së shtunës pas së kremtes së Dëftimit, fq. 119.

⁴¹ Lutja pas kungimit në javën e III. të Kreshmeve, fq. 145.

⁴² Lutja pas kungimit, e premtja pas të Merkurës së Përhime, fq. 124.

⁴³ Mt 8, 8.

⁴⁴ *Meshari Romak*, fq. 419.

*healed.*⁴⁵ (O Zot, unë nuk jam i denjë të pranoj ty, por thuaje vetëm një fjalë e unë do të shërohem). Shqipja i është përmbajtur latinishtes (shpirti im – anima mea) dhe tregon gjurmët e neoplatonizmit. Vdekja dhe ngjallja e Krishtit na jep të drejtë që të shërohemi edhe në shpirt edhe në trup.

⁴⁵ *New Saint Josef's Weekday Missal*. Complete Edition, Vol. II. – Pentecost to Advent, Catholic book Publishing Co. New York 1975, Communion Rite, fq. 649. (nënvizimet: M. Čunčić).

Format e shërimit

Në popullin e Zotit gjithmonë kanë ndodhur shërime të mrekullueshme. Në librat e ndryshëm të uratëve të sëmurët porositen që të lutën vetë për shërimin e tyre, sikurse që shkruan në njërin prej tyre: “Të lutem që të bësh mrekulli në shpirtin dhe trupin tim dhe t’i shërosh”.⁴⁶

Shën Tomë i Akuini e quan mrekulli dukurinë e jashtëzakonshme që është jashtë rrjedhave të zakonshme natyrore. Nuk është me rëndësi sa është e jashtëzakonshme, por a bën pjesë në dukuritë natyrore apo jo. Me këte pajtohen edhe teologët e sotëm. Edhe pse një gjë ndodh çdo ditë, megjithatë është mrekulli, nëse nuk i takon gjërave natyrore. Prej librit *Miracles* sjell përshkrimin sesi ndodhin mrekullitë: “Mrekullitë ndodhin gjithmonë, por nuk jemi të vetëdijsëm. Dhe shpesh janë të mundura, por ne vërtet nuk i kërkojmë. Një shoqe imja më ka thënë: “Nuk çuditem pse Zoti nuk i dëgjon lutjet e mia. Në të shumtën e rasteve as unë vetë nuk i dëgjoj.” Kështu lutet shumica prej nesh: murmurisim diçka, por nuk jemi në komunikim. Kur ndodh mrekullia, ndodh sepse njerëzit janë të pikëlluar dhe atëherë janë në komunikim.”⁴⁷

Besimtarët shpesh herë porosisin meshë të shenjta për shëndetin e vet ose të të afërmeve të vet. Kjo është praktikë e njohur dhe e përhapur. Në Kishë shpesh ndodhin

⁴⁶ *Slavimo Boga*. Lutja në sëmundje, fq. 46.

⁴⁷ Mitch Finley, “Miracles: a living part of Catholic faith”, *Our Sunday Visitor*, May 21, 1989, 8. Intervistë me motrën Mery Hester Valentine, S. S. N. D., autore e librit *Miracle*.

shërime të mrekullueshme me ndërmjetësimin e ndonjë të dashuri të Zotit dhe ato janë dhuratë e qiellit për të vërtetuar shenjtërinë e tij. Shërimet e pashpjegueshme me ndërmjetësimin e dikujt që ka vdekur, e që njerëzit e kanë konsideruar të shenjtë, janë signal për Kishën se ai mund të shpallet i lumtur, e nëse është i lumtur që të shpallet i shenjtë. Mbi këte dëshmojnë me dhjetra mijëra faqe dokumentacioni që mblidhet në Vatikan për secilin të lumtur dhe shenjt.

Ndodhin shumë shërime në kishat anembanë botës. P. sh. në shenjtëroren e Martirëve të parë kanadezë në Midland (Ontario, Kanada) shihen shumë paterica, të cilat i kanë lënë të sëmurët, sepse janë shëruar. Ka patur edhe shërime të tjera prej të cilave nuk ka shenja të dukshme. Rregulltari i shenjtë e i përvuajtur Andreu ka tërhequr një mori njerëzish prej Amerikës Veriore në Montreal, sepse nëpër lutjen e tij dhe ndërmjetësimin e shën Jozefit janë shëruar shumë. Ka ndërtuar bazilikën më të madhe të shën Jozefit, e treta ose e katërta më e madhja kishë, në përgjithsi, në botë. Në mes tjerash shumica kanë ecur atje, për çka dëshmojnë paterica të shumta të varura në hapësirën e caktuar enkas për këte. Ka vdekur në shekullin njëzet, dhe e ka përcjellur mbarë Amerika Veriore katolike në parakalim, ashtu si përcillet p. sh. kryetari i shtetit.

Në shenjtëroret si Lurdi, Fatima, Maria Bistrica, Megjugorje, e shumë të tjera, me miliona besimtarë shtegtojnë që të lusin për shëndet. Në Lurd është bazeni për larje. Në momentin e dëftimit të Nënës së Zotit, uji ka filluar të dalë kur shën Bernardeta ka grithur në tokë, ashtu siç i kishte thënë Nëna Qiellore. Besimtarët e bartin atë ujë në shishe në mbarë botën dhe me besim në shërim, e pinë

më gjatë se një shekull. Përmbajtja e ujit është e thjeshtë. Njerëzit shërohen me fe. Në shenjtëroren kombëtare kroate Maria Bistrica gjenden afreskat përreth kishës, në të cilat janë të paraqitura mrekullitë e Virgjërës së Lume Mari, në mes tjerash edhe mrekullitë e shërimit.

Në Kishë mrekullitë nuk ndodhin vetëm nëpër lutjen individuale, por jemi dëshmitarë të paraqitjes së meshtarëve dhe laikëve të cilët kanë përqaftuar dërgimin e dyfishtë burimor që ua ka dhënë Krishti: “Pastaj i dërgoi të shpallin Mbretërinë e Hyjit dhe të shërojnë të sëmurët”.⁴⁸ Këto dy dërgime: shpallja dhe shërimi, nuk mund të ndahen – sepse arrdhja e Mretërisë së Hyjit pikërisht shihet kur Zoti shëron popullin e vet: “Ata u nisën dhe rende-rendas u ranë fshatrave duke predikuar Ungjillin e duke shëruar gjithkund.”⁴⁹ Është e nevojshme që të bëhen që të dyjat. *People are preached to death* (Njerëzit janë ngirë deri në vdekje me predikime) thotë ati Robert DeGrandis.⁵⁰ Kur meshtari vjen që të lutet për shërim, njerëzit e rrethojnë, sepse në mënyrë instinktive kanë nevojë të madhe për shërim. Nuk mjafton vetëm shpallja, është e nevojshme që të lehtësohet barra e dëgjuesve me lutjen për shëndetin shpirtëror, mental dhe trupor. Është fakt se edhe sot, si dikur, njerëzit dëshirojnë me gjithë shpirt shërimin nëpërmes lutjes.⁵¹ Nëse predikohet për

⁴⁸ Lk 9, 2 citati M. Ç.

⁴⁹ Lk 9, 6.

⁵⁰ Robert DeGrandis, S.S.J., *Lay Person's Manual for the Healing Ministry*, s. l., Printed in USA, 1985, 6.

⁵¹ Këtë e vërtetojnë ata që në kërkimin për shërim kanë shkuar në okultizëm. Besohet se shumë prej këtyre besimtarëve më parë do të kishin arrdhur në lutje në Kishë, nëse do të kishte rregulisht

shërimet që kanë ndodhur para 2000 vjetve, është njësoj sikurse të uriturve t'u flitet se njerëzit para 2000 vjetëve kanë ngrënë. Dashuria e Zotit nuk mbetet në fjalët e bukura. Krishti edhe sot bën mrekulli dhe shëron si dikur. Me këtë dihet se ka arritur Mbretëria qiellore. Në vitin B, në javën e 23 gjatë vitit, lexohet sesi Jezusi e ka shëruar shurdhmemecin.⁵² Meshtari në homili e ka shpjeguar në kuptimin figurativ këtë mrekulli: që Jezusi na i hap veshët e shpirtit që ta dëgjojmë fjalën e Tij. Pas predikimit ka qenë lutja më konkrete: “O Zot, ti i ke liruar të sëmuret prej sëmundjeve shpirtërore dhe trupore; përsëriti mrekullitë e dashurisë sate edhe sot, të lutemi.”⁵³ Teologu Mato Zovkić flet për të sëmuret në Ungjill kështu: “Edhe pse ka egzegetë të cilët këtu nuk shohin para së

meshë me lutjet e shërimit, si p. sh. në Kanada, dhe me lutje individuale për persona që kërkojnë. Edhe pse tek ne ka raste kur sakramenti i vajimit ndahet në Kishë të gjithë të sëmureve të cilët kanë dëshirë, deri tani këto janë raste të rralla.

⁵² Mk 7, 31-37.

⁵³ Lutjet e përgjithshme të besimtarëve, vëll. I. E Diela A, B, C, Të kremtet e festat. Ditët e veçanta. Kršćanska sadašnjost, Zagreb 1995, 130. Kështu mrekullitë e shërimit të Jezusit shpjegohen si shenjë për rikthimin shpirtëror dhe mental të njeriut. Mjerisht edhe të dhënat e qarta të ungjillit mbi dhuratat e Shpirti Shenjt, ndër të cilat është edhe dhurata e shërimit, shpjegohen në menyrë figurative, sepse nuk besohet, ose nuk konsiderohet e nevojshme, ose e mundur që Jezusi edhe sot ta shërojë dikënd. Shpjegime tipike janë: “Mrekullitë kanë ndodhur në Kishën e parë, që të pranojnë fuqinë për martirizimin, i cili i ka pritur. Sot kjo nuk është e nevojshme dhe nuk ndodh” ose “Kisha e parë ka jetuar ndër paganë dhe për këtë arsye kanë qenë të nevojshme shërimet fizike.” Por edhe sot Kisha ka martirët dhe jeton ndër paganë, randaj dhuratat e Kishës se parë janë shumë të nevojshme.

gjithash nevojat tokësore të njerëzve, megjithate sipas kuptimit të shpëtimit në Besëlidhjen e Vjetër Zoti e shpëton krejt njeriun. Për më tepër Izraeli e përjeton Zotin si shpëtimtar para së gjithash nëpërmes të ndihmës materiale në situata të vështira. Veprat e Jezusit ndaj të sëmurëve, të varfërve dhe të shtypurve janë shenjë e arrdhjes së *Mbretërisë qiellore*.” Nuk bëhet fjalë vetëm për kuptimin figurativ të shërimit trupor. M. Zovkić më tej thotë: “Në apologjetikë kemi mësuar që t’i vlerësojmë shërimet e mrekullueshme të Jezusit dhe ndërmarrjet tjera të mbinatyrshme si argumente të Hyjnisë së tij. Edhe sot, si duket, ka biblistë të cilët nuk mund t’i largohen vlerësimit të tillë. Në kuptimin e shërbimit të Jezusit, mrekullitë janë para së gjithash shfaqje e mëshirës ndaj atyre që vuajnë, shfaqje e dashurisë ndaj njeriut si tërësi.”⁵⁴

Shërbesën e shërimit Krishti e ka bartur edhe në “ata të cilët do të besojnë”; prandaj shumë janë shëruar nëpër lutjen e besimtarëve ashtu sikurse ka thënë Krishti: “Shenjat që do t’i përcjellin *ata që do të besojnë*, janë këto: në emër tim do t’i dëbojnë djajtë, do të flasin gjuhë të reja; [në duar] do t’i marrin gjarpërinjtë e, nëse do të pijnë ndonjë send që sjell vdekjen, nuk do t’u bëjë keq. Do të vënë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen.”⁵⁵

⁵⁴ Mato Zovkić, “Isus patnik i čovjekova patnja u Novom Zavjetu”. Bogoslovna smotra, LIII. Zagreb 1983, nr. 4, fq. 189 dhe 191. (Theksimet M. Ç).

⁵⁵ Mk 16, 17-18.

Nëse diku në Kishë kjo sot nuk ndodhë, është e qartë se mungon lutja: “Nuk keni, sepse nuk luteni”.⁵⁶

Lutja për shërim është në ngritje të vazhdueshme, duke iu falënderuar zgjimit të ri në Kishën Katolike. Me përtëritjen karizmatike, që ka filluar në Pittsburgh me 1966. nga universiteti katolik privat,⁵⁷ ka filluar një periudhë e re në historinë e Kishës. Kjo lëvizje shpirtërore nuk ka ndodhur rastësisht. Papa Gjoni XXIII, të cilin Gjon Pali II e ka shpallur të lumtur në vitin 2000, është lutur në Koncilin II. të Vatikanit (1962-1965) për Rrëshajët e reja. Menjëherë pas kësaj Shpirti Shenjt ka filluar që ta përkujojë Kishën në Rrëshajët e para, duke e befasuar me dhuratat e tija, të cilat kanë qenë të nxitura me Koncil. Në besimtarët janë zgjuar të gjitha dhuratat e Shpirtit Shenjt, të cilat i numëron shën Pali në Letrën dërguar Korintianëve: urtia, dija, feja, dhurata e shërimeve, pushteti i mrekullive, dhurata e profecisë, aftësia e dallimit të shpirtërave, gjuhët e ndryshme dhe dhurata e shtjellimit të gjuhëve.⁵⁸ Neve në mënyrë të veçantë na intereson dhurata e shërimit, pasi që flasim për besimin dhe shëndetin.

Viteve të shtatëdhjeta të shekullit njëzet mbi dhuratën e shërimit ka shkruar Heribert Mühlen si për dukuri e rrallë. Si njohës i përtëritjes karizmatike, në vitin 1976 ka

⁵⁶ Jak 4, 2.

⁵⁷ Duquesne University e udhëheqin regulltarët e Shpirtit Shenjt. Kevin and Dorothy Ranaghan, *Catholic Pentecostals*, Paulist Press, chapter I; Edvard D. O'Connor, C.S.C., *The pentecostal Movement in the Catholic Church*, Ave Maria Press, Notre Dame, Indiana, 46556, sixth printing 1973, 14-15.

⁵⁸ 1 Kor 12, 4-11.

thënë: “Dhurata e shërimeve është vërtetuar në shumë tekste të Besëlidhjes së Vjetër dhe të Re si dhe në historinë e Kishës, edhe pse e veçantë dhe e rrallë dhe në rastin konkret vështirë e vërtetueshme, mbetet gjithmonë e denjë për emrin karizmë e veçantë e Shpirtit.⁵⁹ Dhjetë vjet më vonë nuk do të mund të thuhet më se dhurata e shërimeve është e veçantë dhe e rrallë. Sipas mendimit të abatit benediktin David Geraets, me përtëritjen e liturgjisë dhe të ungjillëzimit, dashurisë ndaj Shkrimet shenjt dhe ndaj Kishës, njëri prej fryteve kryesore të përtëritjes karizmatike është “rritja e shërbesës së shërimeve në Kishën Katolike. Mundësia e shërimit, si dhe mundësia e profetizimit, konsiderohen në Kishën Katolike se është dhuratë e Shpirtit Shenjt, por derisa karizmatikët nuk kanë filluar që të lutën për shërim, kjo dhuratë në të vërtetë ka qenë e porealizuar në Kishën Katolike. Karizmatikët e shohin si shpresë normale të jetës së krishterë.”⁶⁰ Sot dhurata e shërimeve është zgjëruar shumë. Gati që nuk ka bashkësi lutjeje në të cilën dikush nuk e ka këtë dhuratë. Krishti bën që sot shumë vetë të shërohen nëpërmes të lutjes. Përsëri shërimet janë dukuri të përditshme. Nuk është më çudi që të ndodhin mrekullitë. Në tridhjetë vitet e

⁵⁹ Heribert Mühlen, *Die Erneuerung des christlichen Glaubens*, Don Bosco Verlag, München, 1976, 241, Cituar sipas: dr. Ante Kresina, “Karizmatička gibanja kao signa temporum u današnjoj Crkvi” *Bogoslovna Smotra*, god. XLVII, Zagreb 1977, nr. 4, 442.

⁶⁰ O. David Geraets, abat i manastirit Benediktin i Zonjës së Gvadalupes, i bashkësisë karizmatike benediktine në Pecos, New Mexico, në artikullin: Robert Baldwin, “The Catholic Charismatics: Is the ‘renewal’ alive and well?” *Our Sunday Visitor*, August 27, 1989, 8-9.

fundit është botuar literaturë e gjërë, të cilën këtu nuk mund ta përfshij. Shumë libra janë përkthyer në kroatishet dhe mund të gjënden në libraritë katolike, por ekziston shumë literaturë e papërkthyer nga gjuhët e huaja.⁶¹

Të dëgjueshëm naj ndikimeve të Shpirtit Shenjt, katolikët janë nisur në ripërtëritjen e dërgimit të dyfishtë që të predikojnë Fjalën dhe t'i shërojnë të sëmurët. Kështu në Kishë është kthyer profili i shërbimi Zotit, të cilin e ka praktikuar Kisha e parë. Motra e nderit Briege McKenna është njëra nga shumë lutës nëpër të cilët Jezusi shëron

⁶¹. Do të numroj vetëm disa tituj dhe autorë, të cilët rastësisht me kanë rënë në dorë: Betty Topscott, *Inner Healing Through Healing the Memories*, Hunter Publications, Houston, Texas, 1975. (= "Shërimi i brendëshëm nëpër shërimin e kujtimeve"); e njëjta, *Set Free Through Inner Healing*, Hunter Publications, Houston, Texas, 1978. (= "Të liruar nëpër shërimin e brendshëm"); Ruth Stapleton, *The Gift of Inner Healing*, Vord Books, Waco, Texas, 1976. (= "Dhurata e shërimit të brendshëm"); Agnes Sanford, *The Healing Gifts of the Spirit*, Philadelphia and New York: J. B. Lippincott Company, 1966, (= "Dhuratat shëruese të Shpirtit Shenjt"); Francis MacNutt, *Healing*, Ave Maria Press, Notre Dame, Indiana, 1974. (= "Shërimi"); Victor M. Parachin, *Scripture Pathways to Inner Healing*, Liguori Publications, One Liguori Drive, Liguori, MO 63057-9999, 1994 (= "Rruga e Shkrimit Shenjt deri te shërimi i brendshëm"); Dennis Linn & Matthew Linn, *Healing Life's Hurts, Healing Memories Through the Five Stages of Forgiveness*, Paulist Press, New York, N. Y./Mahwah, N. J., 1993. (= "Shërimi i plagëve jetësore, Shërimi i kujtimeve nëpër pesë fazat e faljes"); Mathev & Dennis Linn and Sheila Fabricant, *Prayer Course for Healing Life's Hurts*, Paulist Press, Mahwah, N. J. 1983. (= "Kursi i lutjeve për shërimin e plagëve jetësore"); Mathev & Dennis Linn, *Healing of Memories*, Paulist Press, Mahwah, N. J., 1974. (= "Shërimi i kujtimeve"), etj.

njerëzit në të gjitha kontinentet. Ajo u mban ushtrime shpirtërore meshtarëve. Mbi historinë e thirrjes së saj dhe shërbimeve të shumta për shërim ka shkruar librin “Mrekullitë ndodhin”⁶², Ka mbajtur seminar për shërim të brendëshme në Zagreb në sallën sportive.⁶³ Motra e nderit Francis Clare gjithashtu është murgeshë e Kishës katolike në ShBA, e cila është kyçur në shërbimin e shërimit në ripërtëritjen karizmatike. Anëmbanë botës predikon fuqinë e mrekullueshme të dashurisë së Jezu Kirshtit. Dhe nëpër duart e saja Zoti shëron shpirtin, trupin dhe psihën, krijon pjesë të reja të trupit dhe mjekon në mënyrë të mrekullueshme popullin e vet. Është autore e shumë librave.⁶⁴

Nga shumë meshtarë, të cilët janë në shërbimin e shërimit fizik, shërimit të brendshëm dhe lirimit⁶⁵ do të përmend atin Robert DeGrandis i cili ka qenë në Zagreb

⁶² Briega McKenna, C.S.C., *Čudesna se događaju*, Duh i voda, Jelsa, 1991. (= “Mrekullitë ndodhin”).

⁶³ Zagreb, 12-14. 05. 2000. Organizuar nga P. Ivan Miškić, OFM, Famullia e shën Antonit të Padovës, Zagreb.

⁶⁴ Për shembull: Francis Clare, S. S. N. D., *Your Move God*, New Leaf Press Green Forest, AR.

⁶⁵ Karl Smidth, redemptorist (Toronto, Kanada) vazhdimisht udhëton nëpër botë; Dario Betancourt (New York, ShBA) ka qenë në Kroaci dy herë në Sallën sportive; Ralph DiOrio (Massachusetts, ShBA) ka qendrën ku personeli i tij lutet çdo ditë tetë orë për nevojat e njerzëve anëmbanë Amerikës, që u porositen në lutje, si edhe për suksesin e seminareve të tij për shërim; Rufus Pereira (Bombay, India) ka qendrën nëpër të cilën kalojnë dymbëdhjetë mijë vetë çdo javë; dhe shumë të tjerë.

në vitin 2001,⁶⁶ i është kushtuar shërbimit të shërimit që nga viti 1979. Prej atëherë porosinë kryesore se Zoti na do dhe na shëron e ka shpallur në më shumë se 30 shtete. Është autor i më se njëzet librave të cilët kanë përjetuar shumë botime. I shpjegon mënyrat që ndikojnë në shërim, ndër të tjera, dhjetë urdhërimet e shërimit, pengesat dhe mjetet e shërimit dhe llojet e plagëve shpirtërore.⁶⁷ Ushtrimet e tija shpirtërore për meshtarët në shumë shtete të të gjitha kontinenteve janë përqendruar në fuqinë e shërimit, të cilën mashtarët e pranojnë nëpër sakrametin e shugurimit. Mosfaljen e konsideron si pengesën më të madhe për shërim. Të falurit ka fuqinë më të madhe të shërimit: “Kur të falësh, të jepet paqja dhe shëndeti, dhe plotësia në vend të shkapërderrdhjes”.⁶⁸ Është e njohur urata e tij për faljen, për të rriturit dhe të rinjtë, si dhe urata e tij për shërimin e marrëdhënieve me babain tokësor dhe ne Atin qiellor. Thekson uratën dhe fenë në Zotin, i cili dëshiron që të na shërojë.⁶⁹ Konsideron se qëndrimi ndaj teologjisë së vuajtjes (theology of suffering) është shpesh pengesë për shërim. Duke mos patur dije mbi të gjitha

⁶⁶ P. Ivan Miškić OFM e ka thirur p. Robert DeGrandis-in në Zagreb për të mbajtur seminar në Sallën e sportive, më 16-18. 11. 2001. Përpara ka qënë P. James Manjackal nga India (6-8. 4. 2001.) po ashtu në Sallën sportive, me thirrjen e p. Ivan Miškić-it.

⁶⁷ Disa prej tyre merren me temën e shërimeve: “Shërimi nëpër meshën e shenjtë”, “Shërimi i atyre që janë me zemër të thyer”, “Udhëzuesi për laikët për shërbimin e shërimit”, “Fuqia e lutjes për shërim”, “Shërimi i fotografisë së vetëvetes”, “Falja dhe shërimi i brendshëm”, “Hyrje në shërbimin e shërimit”.

⁶⁸ Robert DeGrandis, S.S.J., *Lay Person's Manual for the Healing Ministry*, s. I., Printed in ShBA, 1985, 9-10.

⁶⁹ 1. Sel 5, 16-18.

fshehtësitë, njeriu mendon që Zoti i dërgon sëmundjet. Pater DeGrandis e ashpëson problemin: “Sipas kësaj logjike, atëherë Zoti do të na dërgonte: alkoholizmin, robërinë drogës, neurozën, psihozën ose sëmundjet shpirtërore siç janë mungesa e fesë dhe shpresës. Kjo do të ishte absurde. Zoti dërgon fenë, e jo mosbesimin, shëndetin, e jo sëmundjen. Ai është autori i së mirës, e jo i së keqes, nuk shkakton sëmundje dhe me qëllim nuk i godet fëmijët e vet. Shëndeti i trupit dhe i shpirtit është dëshira më e madhe e Zotit.” Jezusi i ka shikuar vuajtjet dhe sëmundjet si të keqen, dhe i ka shëruar të gjithë ata që kanë arrdhur tek Ai. Krishit ka shikuar se çka e ka penguar dhe bllokuar njeriun për të arritur maksimumin në kuptim shpirtëror, mental dhe trupor – dhe e ka liruar. DeGrandis vazhdon: “Nuk e jep Zoti sëmundjen, por ne vetë e dëmtojmë shëndetin, duke mos i respektuar ligjet natyrore: të gjithësisë (p. sh. vrima e ozonit), të psikës (p.sh. s’kemi miq), të fizikës (nuk hamë ushqim të shëndoshë, nuk ushtrojmë, nuk jemi në ajër të freskët) dhe të shpirtit (nuk lutemi, nuk lexojmë Shkrimin shenjt). Nëse jetojmë shëndosh, e megjithatë ende vuajmë, vetëm atëherë mund të thuhet se vuajtja jonë është e nevojshme për diçka më të madhe. Mirëpo, kjo nuk na dëshpëron, por na shenjtëron dhe të tjerëve u ndihmon.”⁷⁰

⁷⁰ Robert DeGrandis, S.S.J. *Lay Person's Manuel for the Healing Ministry*, 9-10. E citon Francis MacNutt-in i cili një herë ka thënë: “Kush mendon që Zoti dërgon sëmundjen, bën nga ai monstrum”.

Shëlbimi i plotë

Burimi i shëndetit dhe i fuqisë është Jezu Krishti, Zot e njeri. Atij i krishteri i gëzohet: “Gëzohuni gjithmonë në Zotin! Rishtas po ju them: gëzohuni! Zoti është ngjat”⁷¹ – sepse ai sjell shëlbimin dhe shërimin e plotë: shpirtëror, mental dhe trupor. Shërimi trupor vjen shpesh pas shërimit shpirtëror dhe mental,⁷² që do të shihet më së miri në ditën e ringjalljes së trupit, kur të shëlbuarve trupi do t’u jetë i shëndoshë, pa marrë parasysh sëmundjet gjatë jetës tokësore. Prandaj festat e Krishtit janë paradhënia e lumturisë së amshuar, si në lutjen “që festat e arrdshme të Birit Tënd të jenë burim fuqie në këtë jetë dhe parashijim i lumturisë së amshuar”.⁷³ Kisha lutet për trup dhe për shpirt: “Na ripërtrij në trup dhe në shpirt, që Të shërbëjmë me zemrër të pastër.”⁷⁴ Në lutjen mbi dhuratat, të merkurën e Pashkëve, lutet që Zoti nëpër sakrificën e cila e “shpërblen njeriun, të na japë shëndetin e shpirtit dhe të trupit”.⁷⁵ Zoti dëshiron që populli i tij të ketë shëndetin e

⁷¹ *Meshari Romak*, e diela e III. e Arrdhjes, fq. 86. (Fil 4, 4. 5).

⁷² P. sh. një i gërbulur brenda javës është shëruar, pasi që është rrefyer dhe ka mohuar okultizmin. Video kasete: P. Rufus Pereira në Velika Goricë afer Zagrebit. Një zonjë ka vuajtur nga depresioni, nuk ka punuar dhe reth qafës ka mbajtur rrotullën për fiksimin e kurrizit dhe qafes. Pasi është rrefyer dhe pas Udhës së Kryqit e ka hequr rrotullin. Pastaj është punësuar dhe aktivizuar në shoqëri. Të dhëna më të sakta tek Marica Čunčić.

⁷³ *Meshari Romak*, java e III. e Ardhjes, e Mërkurë, fq. 89.

⁷⁴ Lutja pas: “Lavdi Hyjit në lartësitë qiellore” në Përgimin e Pashkëve.

⁷⁵ Lutja mbi dhurata, të Mërkurën e Pashkëve, fq. 233.

shpirtit dhe të trupit.⁷⁶ Do të shpjegoj më gjërësisht se çka mendohet me shërimin shpirtëror, mental dhe trupor.

Shërimi shpirtëror

Shpëlbimi, apo shërimi, shpirtëror vjen me anë të kthimit. Kur pranojmë dhe lejojmë që shëlbimi i Krishtit të na përfshijë edhe ne, nëpër të falurit e mëkateve në rrëfimin e shenjtë, atëherë ne Jezu Krishtin e pranojmë si Shëlbuesin dhe shpërblyesin tonë. Pendo kemi se e kemi fyer Zotin, i cili është vetë dashuria, “e mira jonë më e madhe dhe më e dashur,”⁷⁷ rrëfejmë mëkatet që të na i falë Zoti dhe kështu ai na shpëton nga denimi i amshuar (ferri). Rruga për këtë shëlbim të amshuar është nëpër lirim nga djalli. Jezu Krishti ka ngadhënjyer mbi djallin, i cili është sipas besimit të krishterë në ferr, por edhe në botë. Duke liru njerëzit nga shpirtat e këqij, Krishti i shpëton nga djalli dhe i shëron. “Kur në Shkrimin shenjt përmenden të robëruarit, mendohet në të djallosurit, prej të cilëve Jezusi i dëbon djajtë, dhe në mëkatarët, të cilëve ua fal mëkatet. Kjo veprimtari e Jezusit është vërtetim i ardhjes, e jo vetëm shenja e afërsisë së Mbretërisë së Zotit.”⁷⁸ Lirimi nga ndikimi i engjëjve të padëgjueshëm, të cilët quhen edhe demonë, djaj, shejtanë, shpirta të ndytë ose shpirta të errësirës, ndodh nëpër sakramentin e pagëzimit, nëpër

⁷⁶ Lutja pas kungimit, më 21 dhjetor, fq. 97.

⁷⁷ Lutja e njohur “Puna e pendimit” që lutet pas rrëfimit, gjëndet gati në çdo libër lutjesh.

⁷⁸ W. Grundmann, *Das Evangelium nach Lukas*, Berlin, 1969, 119-122. Citatet nga Mato Zovkić, vep. e cit., 189.

ripërtërirjen e besëlidhjes së pagëzimit dhe të krezmimit, nëpër rrëfimin, dhe lutjen e lirimit, ose nëse është fjala për djallosje, nëpër egzorcizëm.⁷⁹ Ekzistojë egzorcistët zyrtarë në Kishë, të cilët i emëron Ipeshkvi për ipeshkvinë e vet.⁸⁰ Shkaqet ose rrethanat më të mëdha dhe më të shpeshta të djallëzimit (pushtimit nga djalli), mund të jenë mëkatet e parrëfyera dhe të papenduara, praktikimi i okultizmit,⁸¹ kompleksi i inferioritetit, mosfalja, gjendja e shokut (stresit), “syri i keq” etj.⁸²

Kujdesi i Kishës për shëndetin shpirtëror të besimtarëve, që të jetojnë pa shqetësime të djallit, shihet në lutjen liturgjike, lutjen zyrtare të Kishës, që e lut mbarë Kisha me gjithë ipeshkvijtë, meshtarët, rregulltarët dhe shumë laikë, ku në pasmbremësoren e çdo të marteje lexohet porosia e shën Pjetrit: “Jini të përkorm dhe rrini zgjuar! Armiku juaj, djalli, pors i luan uluritës, endet këndeje dhe andej duke kërkuar (kë) të përpijë. Të fortë në fe, kundërshtoni!”⁸³ Të shtunave, të dielave dhe festave në

⁷⁹Të djallosurit janë të rallë, por janë. P. sh. personin e djallosur nga Velika Gorica e ka liruar egzorcisti dr. sc. Rufus Pereira në vitin 2000. Më shumë informata tek unë.

⁸⁰ Në Kroaci ekziston egzorcisti zyrtar, si në kuadrin e Lëvizjes së Rruzares për kthim dhe paqe, si edhe në kuadrin e shtëpisë Tabor në Samobor afër Zagrebit.

⁸¹ Idhujtaria e çfarëdo lloji: falli, magjia, New Age, satanizmi, bestytnitë, bioenergji, horoskopi, praktikat lindore, (Saibaba, Hare Krishna, reiki, meditimi transcendent etj.). Krahasuar me shtetet tjera, sipas dr. sc. Rufus Pereira, Kroacia ka numër mbimesatar të atyre që merren me okultizëm.

⁸² Ligjërata e mbajtur nga dr. sc. Rufus Pereira, Samobor, Maj 2000, audio kasetat.

⁸³ 1 Pt 5, 8-9, Pasmbrëmësorja, e martë, “Dita me Zotin”, botoi.

mbarim të pasmbramësore lutet: “Vizitoje o Zot, këtë banesë, largoje çdo pritë armiqësore.”⁸⁴

Për këtë qëlim digjet kemi i bekuar gjatë meshës së shenjtë dhe në vende tjera sipas nevojës; stërpiken me ujin e bekuar dhe me të besimtarët bëjnë kryq para hyrjes në kishë, në prona qitet kripë e bekuar. Gjatë bekimit të ujit, kemit, vajit, kripës, dhe sendeve të devotshme, lutet që ata që i përdorin të janë të mbrojtur nga armiqtë e Zotit. Për Krishtlindje lutet për lirimit nga ai që ka shkaktuar mëkatit e parë të njeriut, nëpër të cilin ka adhur sëmudja dhe vdekja. “Të lutëmi që lindja e re trupore e Birit tënd të na sjellë lirimin.”⁸⁵ E dimë se për disa sëmudje fizike dhe psikike nuk ka bar natyror, sepse janë nga burimet shpirtërore dhe kështu mjekohen vetëm nëpër lutje të çlirimit nga errësira shpirtërore, të cilave i sëmuri u bie mohit dhe kthehet kah Jezu Krishti, dhe e pranon për Shëlbuesin e vet.

Ekzistojnë seminarët për shërimin dhe çlirimin e brendshëm të cilët tërheqin shumë besimtarë anembnë botës. Sipas numrit të pjesëmarrësve shihet interesim i madh, i cili rritet pandërprerë.⁸⁶

⁸⁴ Liturgjia e orëve II. Lutja për festa pas mbrëmësore së parë e të dytë.

⁸⁵ Lutja e 30 dhjetorit, dita e 6 në javën e Krishtlindjes, tetorja e Krishtlindjes, fq. 107.

⁸⁶ Seminarët janë mbajtur në stadiume, në famulli dhe qytete të ndryshme në Kroaci. Kanë filluar me lajmëtarin e njohur, meshtarin e Ungjillëzimit të Ri prof. dhe Dekanin e Teologjisë në Zagreb dr. Tomislav Ivančić, i cili e ka themeluar shkollën për Ungjilzimin e Ri në disa shtete të jashtme në Europë, si edhe në Korenë e Jugut. Seminarët i udhëheq edhe Fra Zvezdan Linić në

Shërimi mental

Shëndeti shpirtëror është keqësuar si pasojë e mëkatit. Pa falje dhe pendimi për mëkatet personale, s'ka shëndet shpirtëror. I krishteri praktik pendohet për mëkatet e veta dhe ato i rrëfen, dhe i fal të gjithë që e kanë lënduar. Nëpër faljet e posaçme që Kisha jep prej pasurisë së pamasë të Jezu Krishtit, falen edhe pasojat e mëkatit dhe ndeshkimet e përkohshme. Sëmuremi shpirtërisht për shkak të mungesës së dashurisë, frikës, dhe kompleksit të inferioritetit, streseve të ndryshme dhe të mosfaljes. Për këtë arsye shëndeti shpirtëror mund të kthehet me lutje për shërimin e brendshëm dhe me falje. Kur Zoti viziton njeriun, e ka vizituar dashuria. Bar për plagët e brendshme është dashuria e Zotit dhe pranimi nga ana e tij. Për këtë arsye Zoti na mjekon nëpër ngushëllime dhe inkurajime. Prandaj meshtari lutet: “Na ngushëllo dhe forco me ardhjen Tënde.”⁸⁷ Shëndeti shpirtëror shpesh është i lidhur me shëndetin fizik. Duke shëruar të paralizuarin (Mk 2, 1-

Samobor në shtëpinë “Tabor”, si edhe në shtëpinë “Betania”, Ipeshkvia Krk, të cilët i udhëheq meshtari Zlatko Sudac. Lëvizja Rruzarja për kthim dhe paqe ka organizuar seminarin e Egzorcistit nga Bombaji, doktorit të teologjisë biblike dhe dr. të filozofisë Rufus Pereira: seminari është mbajtur për shërm të mbrendshëm dhe lirim, për meshtarët dhe për laikët me 1999. dhe 2000. në Samobor, dhe në vitin 2000 në Zadër dhe në Sarajevë, Famullia e shën Antonit të Padovës ka organizuar seminar dy herë në sallën e sporteve me meshtarin don Dario Betancourtin nga New Yorku, dhe një seminar me motrën Briega MacKenna nga Irlanda.

⁸⁷ *Meshari Romak*, Lutja e 24 dhjetorit, fq. 100.

12; Mt 9, 1-8; Lk 5, 17-26), Jezusi me shërim ka dhënë edhe faljen e mëkateve. “Që të dyja janë dhurata të pamerituara të Zotit, shenjë dhe vërtetim i shërbimit të Jezusit njerëzve... Shërimi nga sëmundja dhe falja e mëkateve nuk janë larg ndër vete. Shërimi i njeriut nuk ka të bëjë vetëm me trupin. ‘Shpërblimi’ duhet ta përfshijë krejt njeriun, së paku është drejtuar ashtu.”⁸⁸ Edhe njëerën edhe tjetrën dhuratë Jezusi i ka merituar në kryq dhe dëshiron që të na i japë që të dyja.

Shoqata e meshtarëve katolikë terapeutë në Amerikë ka konstatuar se shkaqet kryesore të traumave janë: alkoholizmi – më shpesh pin babai, vdekja e hershme e prindërve ose e një anëtari të familjes, ndarja e papritur nga familja ose nga pridërit, ndarja e prindërve ose mungesa e tyre, defektet në trup, psihë ose shpirt, për të cilat jemi të vetëdijshëm, p. sh. na kanë thirrur: i trashi, i gjati, i vogli etj., sulmi në integritet ose tërësinë e personin (i marrë, kurrë s’dotë bëhesh njeri, budalla etj.), ndjenja e fajit për mëkatet e së kaluarës sonë, të cilat s’mund t’ia falim vetvetes, frika nga dhuna e bashkëshortit ose më të afërmit, vetëdhëmbshuria, ndjenja e të braktisurit, ose ndjenja që nuk jemi të dashur ose të dëshiruar, nuk jemi të çmuar ose jemi të panevojshëm. Frika është shpesh shkaku i shumë sëmundjeve. Për këtë Shëlbuesi jep shpresë dhe kështu e largon frikën: “Thoni atyre që i ka lëshuar zemra: “Mbahuni! Frikë mos kini! Ja, Hyji juaj! Erdhi hakmarrja! Vetë Zoti do të vijë e do t’ju shëlbojë!”⁸⁹ Shumë herë na

⁸⁸ Mato Zovkic, vep. e cit., 190.

⁸⁹ *Meshari Romak*, java e III. e Arrdhjes, lutja pas kungimit, fq. 86. Dal 35, 4.

trimëron në Ungjill, dhe shpesh përsërit: “Mos u frikësoni!”⁹⁰

Këtë lloj shërimi e përfundoj me një të dhënë për qendrën e vetme në botë, të cilën e ka themeluar meshtari prof. dr. Tomislav Ivančić, e që vepron në Zagreb dhe në pjesë të tjera të Kroacisë dhe në disa shtete tjera si edhe në Korenë e Jugut. Kjo është qendra për ndihmën shpirtërore, e cila ndihmon shpirtërisht, ku mjekohet me shenjtëri dhe për këtë arsye edhe quhet **hagioterapia**. Me mijëra njerëz, sidomos gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kroaci, kanë kaluar nëpër këtë qendër.⁹¹

Shërimi trupor

Shpëtimi fizik ose shërimi nuk nënkupton vetëm shpëtimin nga sëmundja vdekjeprurëse, por ky mund të jetë shërim nga çfarëdo sëmundje fizike dhe drejtimi i çfarëdo deformimi fizik. Do të numëroj raste të *ndryshme* të shërimit fizik nëpër lutje, që që i kam të njohura personalisht. Kanadezja Betty O’Sullivan ka qenë e sëmurë më shumë se 10 vjet nga skleroza multiplex. Me lutje dhe leximin e Besëlidhjes së Re, ku Jezusi shëron aq shumë të sëmurë, dhe pas faljes së babait alkoholist, Betty është shëruar. Për këtë ka dëshmuar, sipas thirrjes së famullitarit të Famullisë së shën Kryqit, Georgetown,

⁹⁰ Mt 10, 26; 10, 28; 10, 31; 14, 27; 17, 7; 28, 10; Mk 6, 50; 12, 4; 12, 7; 12, 20.

⁹¹ Qendra për ndihmën shpirtërore, Zagreb, Vodnikova II, ekzistojnë kartotekat e pacientëve, dhe është e mundshme që në mënyrë shkencore të shqyrtohet kjo lëmi.

Ontario, Kanada, para njerëzve të cilët e kanë njohur si të sëmurë. Profesoresha e religjionit dhe ekonomistja në Hamilton është shëruar nga konjuktivitisi kronik, derisa kanë lutur në stadium pas Meshës së shenjtë për të sëmurët. Atëherë shumë janë shëruar nga sëmundje të ndryshme.

Pasi që jam kthyer në Kroaci, jam dëshmitare e shërimeve të shumta në kuadër të lutjeve karizmatike për shërimin fizik. P. sh. janë krijuar harqet na tabanin e rrafshët, nofulla është kthyer në vend, nga veshkat janë zhdukur gurët dhe nuk ka patur nevojë për operim, këmbët e shtanguara janë bërë fleksibile. Është ndalur dhëmbja e ijeve, duart janë rritur, etj.⁹² Këto shërime kanë zgjuar falenderimin ndaj Zotit, dashurinë, gëzimin dhe optimizmin.

⁹² Më shumë informata mund të merrni tek unë.

Përfundim

Njeriu me mëkat ka shkaktuar shumë pasoja negative, që nga vrima e ozonit, e deri tek izolimi në vetmi. Krishti me vdekjen dhe ringjalljen e vet e ka mundur mëkatin, sëmundjen dhe vdekjen, dhe shpresa në shërimin kohor nëpërmes lutjes është legjitime. Kjo del nga Shkrimi shenjtë, sakramenti i vajimit, lutjet liturgjike, qendra e të cilave është Krishti eukaristik, që është burimi i shëndetit. Besimtarët luten për shëndet, kushtojnë meshët e shenjta, shtegtojnë dhe kërkojnë ndërmjetësimin e shenjtërve.

Dërgimi i dyfishtë i dymbëdhjetë apostujve që të shpallin lajmin dhe të shërojnë, çdo ditë e më tepër praktikohet në Kishën Katolike, posaçërisht në takime ripërtëritjeje karizmatike, në të cilat janë të kyçur meshtarët, regulltarët dhe laikët. Ata shpallin Ungjillin dhe luten për shërim dhe lirim. Nëpër shërime dhe lirime shfaqet arrdhja e Mretërisë së Zotit këtu dhe tani.

Tërësia e shëlbimit të Krishtit përfshin shërimin shpirtëror, mental dhe fizik. Shërimi shpirtëror dhe mental është lirim nga djalli, nga pasojat e mëkatin, si edhe nga traumat fizike. Arrihet me anë të sakramentit të pagëzimit dhe të rrëfimit, me egzorcizëm dhe me lutje për shërimin e plagëve shpirtërore. Shërimi fizik nganjëherë është pasojë e shërimin shpirtëror dhe mental, por mund të ndodhë edhe pavarësisht prej tij, ose para tij. Shërmet fizike shumë herë janë nxitje për kthimin kah Zoti.

Jezu Krishti e ka mundur djallin dhe mëkatin, shkaqet kryesore të sëmundjes, dhe ka vendosur themelin e shpresës në shërimin e tërësishëm, si thotë psalmisti: “Ai

shëron të gjitha dobësitë e tua”⁹³ dhe shën Pali: “Jezusi ... mund t’i shëlbojë plotësisht ata që nëpër Të i afrohen Hyjit”⁹⁴ Vetë Krishti thotë: “Unë errdha që delet ta kenë jetën, e ta kenë *me plotësi*”⁹⁵ Çdo besimtar mund të llogarisë me këte, edhe pacienti edhe mjeku. Por për shëndet nuk luten vetëm pacientët nëpër spitale, por është trend në botë lutja për shërim sa më shumë dhe sa më shpesh. Kështu, edhe koha e lirë, sidomos pushimi, mund të planifikohet ashtu që njeriu të pushojë dhe të përtërihet. Famullitë, krahas besimtarëve të vet, do të pranojnë edhe musafirët, të cilët do të kërkojnë ripërtëritje shpirtërore, lutje dhe (ose) personin shpirtëror për bisedë. Çdo ditë është nevoja më e madhe që njeriu i sotëm nëpër fe të arrijë shërimin shpirtëror dhe fizik, pavarësisht ku gjendet. Kur hapësira e kishës bëhet tepër e vogël, takimet e lutjeve mbahen në stadione sportive.

⁹³ Kënga e hyrjes, të shtunën e javës së III të e Kreshmëve, fq. 142. Ps. 103 (102), 4.

⁹⁴ Heb 7, 24. 25.

⁹⁵ Gjn 10, 10.

Shënim për autoren

Dr. sc. Marica Čunčić (lexo: Çunçiq) i përkët bashkësisë laike “Familja e vogël e Zemrës së Papërlyer të Marisë” në Zagreb. Kjo është bashkësi e jetës së kushtuar, e frymëzuar nga Zoja e Bekuar dhe shën Ignaci, e cila kujdest për të rinjtë dhe ka për qëllim për të ngritur jetën shpirtërore. Tani është në Udhëheqësinë e Bashkësisë. Çdo vit bën ushtrime shpirtërore (më tutje në tekst: u. sh.) nga tetë ditë në qetësi, nën udhëheqjen e një meshtari. Dy herë ka patur ushtrime shpirtërore nga një muaj. Më shumë se njëzetë vjetë udhëheq ushtrime shpirtërore për të tjerët. Ka filluar në Kroaci, e ka vazduar në Amerikë dhe në Kanadë për rininë kroate, amerikane dhe kanadeze, si edhe për burrat dhe gratë, në gjuhën kroate dhe angleze, qoftë për grupe, qoftë për individë, nga tri deri në tetë ditë.¹ Më shumë ushtrime shpirtërore ka patur në qendrën shpirtërore Jezuite në Guelphu, që merret me shkollimin e udhëheqësve për ushtrime shpirtërore. Këtu është njohur me dinamikën “ushtrime shpirtërore në jetë” për një përsôn. Ka përgatitur shumë përsônë për rrëfimet jetësore në programin e u. sh. dhe jasht atij programi.

Në Kanada ka udhëhequr ripërtëritjen shpirtërore për të rinjtë kroate, dhe ka përgatitur dy gjenerata për krezmim në famullinë kroate, ka dhënë mësim feje në dy

¹ Audiokasetat e u. sh. kroatisht dhe anglisht mund të porositen në adresë: M. Čunčić, Tomacova 16, HR – 10419 Vukovina.

shkolla të mesme kroate (Oktaville dhe Toronto). Ka patur dy herë ripërtëritje shpirtërore për kandidatët për krezmimi në famullinë kanadeze. Në ripërtëritjen karizmatike ka hyrë nëpërmjet një grupi të lutjes në një famulli kanadeze. Ka qenë në seminarin “Jeta në Shpirt” në mënyrë pasive dhe aktive. Ka kaluar semianret që janë zhvilluar për ata që luten për shërim. Tri vjet Dr. Marica Čunčić e ka udhëhequr grupin karizmatik kroat në një famulli kroate të “Shenjtërueshmes Trini” në Oakville dhe një vit në banesën e vet në Brampton. Ka marrë pjesë në shumë takime katolike të lutjes në Kanada dhe në Amerikë. Në thirjen e atit sllovak Jezuit ka ndihmuar në takimet “Cenacolo” të sllovakëve në Toronto. Në Kanada ajo është njohur me programin e ripërtëritjes shpirtërore për shkollat e mesme ku ka dhënë dëshmi para shumë të rinjve për jetën e vet në Krishtin. Pas kthimit të saj në Kroaci nga Kanadaja në vitin 1997 ka pranuar për të udhëhequr të rinjtë në takimet e lutjes javore, ku punon edhe tani. Ka udhëhequr ushtrimet shpirtërore për tre meshtarë dhe për një profesoreshë nga bashkësia “Emanuel” në Kanada. Nëpërmjet “ushtrimeve shpirtërore në jetë”, të cilat zgjasin 30 javë, më së pari e ka udhëhequr një person, pastaj dy dhe pastaj katër persona. Në vitin 2001 ka pasur njëzet të rinjë dhe një motër në këtë program. Në çdo javë ajo bisedonte me çdo njërin një orë dhe udhëheqte takime të përbashkëta. Ka organizuar korin në kapelën e shën Fabianit dhe Sebastianit në Kuçama, famulli Vukovina, dhe ka udhëhequr korin një vit derisa ka arritur të punojë vetë. Ka përpiluar dhe botuar librin “Gjithçka për Jesusin” për një vajzë të shenjtë Anne de Guigné. Libri është një

mjet i mirë për të edukuar fëmijet dhe për përgatitjen për rreftimin dhe kungimin e parë.² Dr. M. Čunčić është një autore dhe udhëheqëse e “Bashkësive të punës shpirtërore” në radion kroate katolike (25. 3. – 24. 6. 2000).³ Në kuvendin “Bijat e Zojës Ndihmëtare” ka bërë tri here ripërtëritje shpirtërore. Ka zhvilluar shumë ligjerata në famullitë (Zagreb, Velika Gorica, Blato na Cetini, Dubrovnik, Sarajevo, Vukovina) dhe ka dhënë dëshmi në takime të grupeve të lutjes në Dubrovnik, Vojniq afër Sinjit, Megjugorje, Vjenë dhe Wells. Ka patur ripërtëritje shpirtërore në kishën e Grabit (BiH) dhe ka mbajtur seminarë në famullitë Preko në Ugljan.

Në degën e vet të shkencës dr. Marica Čunčić është autorja e shumë librave dhe artikujve, si shfrytëzuese e bursës së Fullbright-it ka qenë profesoreshë në Universitetin Amerikan. Në Kanada ka qenë bashkëpunëtore e jashtme e institutit Papnor për shekullin e mesëm në Toronto dhe ka mbajtur ligjërata në universitete, kolegje dhe në shkollat e mesme. Për pesë vjet ka qenë drejtoreshë e redaksisë së revistës Gaudeamus, një revistë e intelektualëve kroatë në gjuhën angleze për Amerikën Veriore. Tani punon në institutin për sllavistikën e vjetër, dhe jep ligjërata për trashëgiminë e glagolicës (shkrimi i vjetër i gjuhës kroate) në Fakultetin filozofik të Jezuitëve në Zagreb.

² Mund të porositet në të njëjtën adresë. Janë falur 2000 ekzemplarë Kryepeshkvisë së Sarajevës, që të ndahen falas nëpër shkolla dhe famulli, si edhe individëve në BiH.

³ Emisionet e regjistruara në kasetë mund të porositet në të njëjtën adresë. Përveç lutjes dhe temave shpirtërore, kishte biseda edhe me dëgjues. Mysafirët e emisionit ishin, p. sh.: dr. sc. P. Rufus Pereira nga India, mr. sc. Erika Gibello nga Anglia, Anne Marie Beurs, prof. nga Franca.

PËRMBAJTJA

Parathënie	3
Hyrje	5
Prej nga sëmundjet e shumta	7
Legjitimiteti i shpresës në shërim me anë të lutjes	11
Format e shërimit	21
Shëlbimi i plotë	32
<i>Shërimi shpirtëror</i>	33
<i>Shërimi mental</i>	38
<i>Shërimi trupor</i>	23
Përfundim	40
Shënim për autoren	42
Përmbajtja	45

(NB!

***Teksti i poshtëm,
në fq. nr. 47,
shkon në faqen
e fundit të
kopertinës,
përfundimisht!!!)***

Në këtë librezë nxitëse lexojmë edhe fjalitë e më poshtme: “Krishti edhe sot po bën mrekulli sikur përpara. Me këtë ne e dimë se ka ardhur mbretëria e Zotit... Prandaj është mirë që të lutemi më shpresë të madhe: Zotëri, Ti ke liruar të sëmuret nga sëmundje shpirtërore dhe trupore: ripërtërij mrekullitë e dashurisë sate edhe sot... Në rrugën e shëlbimit të Jezusit mrekullitë janë në rend të parë për të treguar mëshirën ndaj të sëmurve, dashuri dhe ndërim ndaj gjithë qënies së tyre...”

Lutja për shërim është në rritje të vazhdueshme, duke u falenderuar ripërtëritjeve shpirtërore të reja “karizmatike” në Kishën Katolike... Kjo levizje nuk ka ndodhur rastësisht. Papa Gjon XXIII, të cilin Gjon Pali i II. e ka shpallur të lumtur në vitin 2000, është lutur në Koncilin e II. Vatikanas për Rrëshajë të reja. Pas kësaj Shpirti Shenjt ka filluar të përkujtojë Kishën në ditën e Rrëshajve të para, duke e befasuar me dhurata të veta, të cilat kanë qenë nxitur me anë të Koncilit. Tek besimtarët janë zgjuar të gjitha dhuratat e Shpirtit Shenjt të cilat i numëron shën Pali në Letrën Korintasve: urtia, dija, feja, dhe dhuratat e shërimit, pushteti për të bërë mrekulli, profecitë, gjuhët e ndryshme, dhe dhurata e shtjellimit të gjuhëve. Në këtë librezë është shpjegimi i dhuratës së shërimit.”